

VENDIM
Nr. 257, datë 21.12.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

(ndryshuar me vendimin nr. 67, datë 3.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/7 prot., datë 17.12.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 238, datë 26.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 6/24 prot., datë 26.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe, në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e trea (data 14.12.2021), nuk rezultoi të ketë të tilla, në lidhje me këtë aplikim.

- Me shkresën nr. 1074/1 prot., datë 2.12.2021, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar sipas vendimit nr. 238/2021”.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën përfundimtare të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.
- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht:
 - neni 9, pika 2
 - germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), shoqëria ka përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj, ku përfshihet

administratori, përgjegjësi i nënstacionit, si dhe elektrikistët dhe ndihmëselektricitët e nënstacionit, por në kuadër të kësaj licence, ajo duhet të përcjellë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti